

RAPORT NGA GRUPI I AUDITIMIT SOCIAL RAHOVEC

PROJEKTI I MONITORUAR

**NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA
(RAHOVEC, XËRXË, FORTESË, KRUSHË E MADHE, CELINË, HOQË E VOGËL,
OPTERUSHE, MALËSI E VOGËL, RATHOC, DEJN DHE QIFLLAK)**





Norwegian Embassy

RAPORT NGA GRUPI I AUDITIMIT SOCIAL RAHOVEC

PROJEKTI I MONITORUAR

NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA (RAHOVEC, XËRXË, FORTESË, KRUSHË E MADHE, CELINË, HOQË E VOGËL, OPTERUSHE, MALËSI E VOGËL, RATHOC, DEJN DHE QIFLLAK)



Opinionet e shprehura në këtë raport nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë, Qeverive të Zvicrës, Suedisë, Norvegjisë e as të HELVETAS Swiss Intercooperation.

PËRMBAJTJA

7	Rreth DEMOS
7	Rreth Platforma CiviKos
8	Auditimi Social: Pse mbështetet nga DEMOS dhe çfarë ka për qëllim?
9	Hyrje
10	Përmbledhje Ekzekutive
13	Rreth Auditimit Social
14	Hapat e Procesit të Auditimit Social
14	Metodologjia
14	Përzgjedhja e Projekteve dhe Komunave
17	Procesi i Auditimit Social në Komunën e Rahovecit
17	Themelimi i Grupit të Auditimit Social në Rahovec
17	Takimet e Rregullta të Grupit të Auditimit Social në Rahovec
18	Qëllimi Specifik i Grupit të Auditimit Social në Rahovec
18	Kërkesat për informacion/dokumente si dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Rahovec tek Komuna e Rahovecit
20	Rreth Projektit
21	Gjetjet Kryesore
23	Rekomandimet
24	Lista e Përbërjes së Grupit të Auditimit Social

Rreth **DEMOS** Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), është projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra, Suedia dhe Norvegjia, zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

DEMOS përkrahë të gjitha komunat e Kosovës për të sjellë ndryshime sistemike që nxisin qeverisjen e mirë, dhe ofrimin e shërbimeve më të mira që ndikojnë pozitivisht në jetën e përditshme të qytetarëve.

DEMOS III ka për objektive të përgjithshme përmirësimin e performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime, për të kontribuar në rritjen e kënaqësisë së qytetarëve.

Rreth platforma **CIVIKOS**

Platforma CiviKos është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe promovuar një mjedis të përshtatshëm për bashkëpunim formal dhe të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

Në rritje të vazhdueshme dhe aktualisht me rreth 300 organizata anëtare të shoqërisë civile, Platforma CiviKos është e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave anëtare, autoriteteve publike, dhe palëve të tjera të interesuara në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Me misionin e saj për të mundësuar një mjedis të favorshëm të shoqërisë civile në Kosovë, dhe anëtarësisë së saj në të gjitha rajonet e Kosovës, Platforma CiviKos vazhdon që të angazhohet në mënyrë aktive, në mbështetjen e anëtarëve të saj që veprojnë në nivel lokal dhe promovimin e pjesëmarrjes demokratike në nivel lokal.

AUDITIMI SOCIAL:

Pse mbështetet nga DEMOS dhe çfarë ka për qëllim?

DEMOS përkrahë komunat në bazë të performancës së tyre, duke përdorur Grantin e Performancës si mjet kryesor të saj. Sa më e mirë të jetë performanca e komunës, aq më e lartë është shuma e grantit. Performanca komunale vlerësohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Duke zhvilluar konkurrencën pozitive në mes të komunave, granti i performancës rrjedhimisht nxitë ndryshime pozitive në sjelljen e komunave për përmirësimin e qeverisjes demokratike, menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore, transparencës dhe integritetit.

Përveç Grantit të Performancës, DEMOS ofron asistencë teknike për stafin komunal që i fuqizon ata për të dhënë rezultate më të mira. Asistenca teknike ofrohet në fushat ku performanca konsiderohet të jetë më e dobët.

DEMOS gjithashtu përkrahë qeverinë qendrore në politikat sistemike, për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar.

Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të inicojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (MPG) tek qytetarët.

Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është të përfshijë organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në kryerjen e auditimeve sociale për të monitoruar projektet e Grantit të Performancës Komunale (MPG) të zbatuar nga komunat.

Për të zbutur rreziqet e besueshmërisë së fondeve të Grantit të Performancës, dhe njëkohësisht për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, DEMOS ka vendosur auditime sociale brenda Grantit të Performancës Komunale (në sistem). Auditimet sociale do të përfshijnë edhe monitorimin e performancës dhe proceset e planifikimit të projekteve në nivel komunal. Projekti do të mbështesë zhvillimin e mjeteve dhe metodologjive të kampionimit, duke përfshirë trajnime për të kryer me sukses auditime të tilla sociale. Auditimet sociale të lartpërmendura do të financohen nga një pjesë e fondeve të Grantit të Performancës Komunale dhe do të zhvillohen nga organizata të shoqërisë civile. Për këtë, DEMOS do të jetë partner me OSHC-të kryesore.

HYRJE

Ky është një raport përmbledhës i Grupit të Auditimit Social të përbërë nga qytetarë aktivist, anëtarë të organizatave të ndryshme nga Rahoveci, të cilët janë bashkuar grupit të Auditimit Social për të monitoruar zbatimin e “Projektit për ndërtimi e infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak)”.

Raporti elaboron metodologjinë e ndjekur nga Grupi i Auditimit Social, veprimet për mbledhjen e të dhënave - duke përfshirë vizitat në terren dhe diskutimet me Kryetarin dhe përfaqësues të Komunës, dhe elaborimin e gjetjeve dhe rekomandimeve.

Auditimi social është bërë i mundur falë mbështetjes së Projekti për Decentralizim dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS), projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra, Suedia dhe Norvegjia, i zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

DEMOS përmes këtij aktiviteti synon të instalojë auditimin social si pjesë të kulturës së monitorimit qytetar për projektet kapitale të zbatuara nga komunat.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2022, me mbështetjen nga Projekti DEMOS, Platforma CiviKos ka identifikuar një grup qytetarësh dhe përfaqësuesish të grupeve të organizuara të qytetarëve për të monitoruar zbatimin dhe mbarëvajtjen e investimit kapital në Komunën e Rahovecit, që ka për qëllim ndërtimin e infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në qytet dhe fshatrat përreth.

Investimi në fjalë, me vlerë prej EUR 71,569.00,

parasheh punët përgatitore, ndërtimin e pjerrinave, vendosjen e shenjave vertikale dhe horizontale, vendosjen e tabelave informuese, vendosjen e anësoreve, shenjzimin e parkingjeve si dhe vendosjen e sinjalistikës dhe zhurmueseve për persona të verbër në dy kryqëzimet të cilat janë të rregulluara me semafor.

Gjatë kësaj periudhe dymujore, 21 qytetarë kanë marrë pjesë në një trajnim intensiv dyditor dhe në pesë takime tjera, duke përfshirë takime në terren dhe takime me Kryetarin dhe përfaqësues tjerë të Komunës së Rahovecit. Përbërja e Grupit të Auditimit Social është përcaktuar në bazë të ndikimit që ka projekti i Komunës në grupe të ndryshme të popullsisë, e sidomos ato të marginalizuara. Më saktësisht Platforma CiviKos, si pjesë integrale të këtij grupi, ka ftuar për të marrë pjesë anëtarë nga HANDIKOS dega në Rahovec, të cilët më së miri janë të njohur me vështirësitë e personave me nevoja të veçanta. Përveç që në këtë auditim social është stimuluar edhe pjesëmarrja e grave dhe të rinjve, vlen të theksohet se grupi në përbërje kishte edhe arkitekt e jurist, si dhe përfaqësues të profesioneve të ndryshme relevante të cilët kishin kontribuar në kuptimin më të lehtë të kërkesave dhe detyrimeve kontraktuale. Duke qenë se projekti në tërësi ka një shtrirje të gjerë në aspektin gjeografik dhe me barrë logjistike për qytetarët e angazhuar në këtë monitorim, fokusi i Grupit të Auditimit Social ishte realizimi i projektit në qytetin e Rahovecit.

Projekti i Komunës, i kontraktuar përmes procedurës së hapur të prokurimit, me emrin **‘Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Ofterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak’**, sipas Grupit për Auditim Social deri në një masë është zbatuar siç duhet. Megjithatë, Grupi i Auditimit Social ka ngritur disa shqetësime, jo vetëm rreth mbarëvajtjes së realizimit të projektit, por edhe procesit të planifikimit të tij.

Ndonëse ky projekt ishte rrjedhojë e kërkesave të qytetarëve, monitorimi ka identifikuar se komuniteti kyç i cili do të duhej të përfitonte nga ky projekt nuk ishte konsultuar në fazën e planifikimit të projektit. Si pasojë e mungesës së konsultimit publik gjatë planifikimit, e sidomos grupeve të ngushta të interesit, projekti në vete

kishte disa mangësi dhe parregullsi të natyrës teknike, e të cilat do të mund të ishin evituar. Një nga mangësitë kryesore nga mos konsultimi publik ishte identifikimi i duhur për vendosjen e pjerrinave dhe shenjzimeve, duke kontribuar që pjerrinat të mos vendosen vetëm në vendkalimet dhe shkollat ku të tillat kanë munguar, mirëpo edhe në hapësirat me frekuentim të shpeshtë, përshirë objektin e Komunës së Rahovecit.

Lidhur me këtë gjatë monitorimit, Grupi i Auditimit Social ka identifikuar edhe në një vështirësi tjetër. Zyra e Kryetarit të Komunës ishte në katet e larta të objektit, dhe si rezultat mungesa e ashensorit në objektin e Komunës e pamundësonte qasjen e personave me nevoja të veçanta në zyrën e tij. Një mangësi tjetër që monitorimi kishte gjetur ishte dëmtimi i tërësishëm i pjerrinave gjatë ndërtimit të sheshit të qytetit, duke mos lënë mundësi kyçje në shesh për persona me nevoja të veçanta. Këto mangësi teknike, të identifikuara gjatë monitorimit ishin edhe ndër shkaktarët kryesorë të vonesës prej 196 ditësh në implementimin e projektit. Një nga këto probleme ishte keqplanifikimi i dimenzioneve të rrethojave, pasi ishin planifikuar me dimenzione më të mëdha se trotualet, e në të cilat ishte dashur të intervenohej pas fillimit të zbatimit të kontratës. Problemi me dimenzione ishte identifikuar edhe në pjerrinat e ndërtuara, pasi disa nga to ishin më të ngushta se standardi i lejuar për të kaluar një person me karrocë.

Monitorimi kishte identifikuar edhe probleme në sinjalistikën e vendosur. Tingulli i zhurmueseve të vendosur në semaforë ishte aq i ulët saqë shpeshherë ato nuk mund të dëgjohen nga personat e verbër dhe personat me vështirësi në të dëgjuar. Në vazhdim, monitorimi kishte identifikuar se edhe shenjat vertikale dhe horizontale nuk ishin vendosur në të gjithë qytetin e Rahovecit për të njoftuar qytetarët me nevoja të veçanta për shtigjet për persona me nevoja të veçanta, duke e bërë kështu të paqartë qëllimin e shtigjeve për shfrytëzuesit e trafikut.

Një shqetësim i veçantë i Grupit të Auditimit Social ishte se Komuna e Rahovecit nuk kishte një kontratë për mirëmbajtje të rrethojave, pjerrinave dhe shenjave, të cilat degradohen me kohën, duke rrezikuar që pas një kohe këto investime të ishin të papërdorshme dhe të padobishme për komunitetin.

Synimi i Grupit për Auditim Social është që Komuna e Rahovecit, përveç përmirësimit të komunikimit të mirëfilltë me qytetarë e sidomos në projektet të cilat ndikojnë direkt në jetën e tyre, gjithashtu të marr masa konkrete si: Masa për zgjerimin e pjerrinave të vendosura në vendkalime për këmbësorë që aktualisht janë nën standardin, me qëllim të funksionalizimit të këtij investimi e që do të mundësonte kalimin e një personi me karrocë; Të rritet tingulli i zhurmueseve të vendosur në semafor në mënyrë që qytetarët ta dëgjojnë atë; Të vendosën të gjitha shenjat vertikale dhe horizontale që tregojnë vendkalimet për persona me nevoja të veçanta për të gjithë përdoruesit, e që do të evitonte bllokimet nga veturat e ndalura, apo rrezikimi nga ngasësit e biçikletave, etj. Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së investimit, Grupi i Auditimit Social synon të nxis Komunën që të siguroj sa më shpejtë një kontratë për mirëmbajtjen e rrethojave, pjerrinave, shenjave vertikale dhe horizontale në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuaeve, si dhe të siguroj që pjerrinat e dëmtuara

gjatë ndërtimit të sheshit të rikthehen dhe të funksionalizohen.

Komuna e ka mirëpritur angazhimin qytetar për të përmirësuar implementimin e projektit në fjalë me ç'rast është zotuar të marr parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Grupit të Auditimit Social. Në vazhdim, Komuna ka sqaruar për Grupin se problemet me standardet e pjerrinave, mungesën e shenjave horizontale, vertikale dhe anësoreve vijnë si pasojë e mungesës së hapësirës. Ndërsa sa i përket zhurmueseve dhe qasjes në shesh të qytetit, Komuna bëri një premtim për angazhim të menjëhershëm në adresimin e tyre. Në vazhdim, Komuna po ashtu u zotua të përfshijë mirëmbajtjen e pjerrinave dhe shënjueseve në kuadër të shërbimeve publike të Komunës, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së këtij investimi.

Të gjitha palët e përfshira ishin mirënjohëse për ndihmën e ofruar nga Platforma CiviKos, dhe DEMOS për të thelluar bashkëpunimin e Komunës me qytetarët. Duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e dala nga procesi i auditimit social, Grupi i Auditimit Social do të vazhdojë të monitorojë zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga ky raport, duke i mbajtur qytetarët të informuar për zhvillimet e reja.

RRETH AUDITIMIT SOCIAL

Sipas udhëzuesit të përgatitur nga DEMOS, auditimi social është njëra nga disa qasjet drejt arritjes së llogaridhënies sociale, përmes një procesi të angazhimit konstruktiv ndërmjet qytetarëve, qeverisë, shoqërisë civile, dhe në disa raste edhe palëve të interesuara të sektorit privat për të vlerësuar sjelljen dhe performancën e zyrtarëve publik, udhëheqësve të zgjedhur dhe ofrueseve të shërbimeve që përdorin burimet publike për të ofruar shërbime, për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit dhe për të mbrojtur të drejtat e njerëzve.

Auditimi social bazohet në parimet themelore të qeverisjes demokratike dhe të mirë, që do të thotë se procesi është pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, transparent, me qasje në informatat e nevojshme dhe se vendimmarrësit dhe politikë bërësit mbahen përgjegjës.

Auditimet sociale nuk duhet të ngatërrohen me auditimet formale dhe financiare, mirëpo ato janë element thelbësor me potencial të plotësojnë auditimet financiare tradicionale për të ndihmuar institucionet publike të krahasojnë performancën e tyre të përgjithshme. Raportet e auditimit social, e në veçanti rezultatet që gjenerohen nga to, mund të përdoren për t'u përfshirë edhe në planet vjetore të auditimit të brendshëm të komunave.

Auditimet sociale ndonjëherë ndërmerren si një ngjarje e vetme, por janë më efektive kur kryhen në mënyrë sistematike si një proces që realizohet në intervale të rregullta. Për të mundësuar këtë, është thelbësore të ndërtohet një mirëkuptim i përbashkët dhe pronësi reciproke e auditimit social ndërmjet palëve përkatëse të interesuara. Kur janë të suksesshme, proceset e llogaridhënies sociale çojnë në përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike, zbatimin e projekteve dhe ofrimin e shërbimeve dhe politikave publike nga të cilat përfitojnë njerëzit, veçanërisht grupet e marginalizuara të shoqërisë. Nëse kryhet rregullisht dhe në mënyrë konstruktive, procesi dhe rezultatet e tij kanë treguar se forcojnë besimin e ndërsjellë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve qeveritare.

Bashkëpunimi në mes të DEMOS dhe Platforma CiviKos ka për qëllim krijimin e infrastrukturës për auditim social. Meqë është një formë e re e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe autoriteteve publike, ndërtimi i kapaciteteve është i domosdoshëm. Andaj, ky bashkëpunim ka filluar me pilotim të auditimit social në katër komuna: Pejë, Kamenicë, Lipjan dhe Rahovec. Përmes aktiviteteve në këtë projekt, DEMOS dhe Platforma CiviKos synojnë të instalojnë këtë metodologji tek autoritetet publike në Kosovë dhe shoqëria civile, në mënyrë që të zhvillohet edhe më tutje si praktikë në të ardhmen për projekte të ndryshme kapitale.

HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Platforma CiviKos duke u bazuar në hapat e metodologjisë së auditimit social të DEMOS, ka punuar aktivisht në krijimin e infrastrukturës për monitorimin e katër projekteve kapitale në katër komunat partnere. Gjegjësisht, në Pejë, Kamenicë, Lipjan dhe Rahovec. Metodologjia dhe qasja janë ndërtuar përgjatë një procesi dhe diskutimi të thukët në mes të Platformës CiviKos dhe DEMOS. Pjesët në vazhdim do të shtjellojnë secilin hap që ka formësuar këtë bashkëpunim dhe ka vënë themelet për zhvillimin e konceptit të auditimit social në Kosovë.

METODOLOGJIA

Përzgjedhja e Projekteve dhe Komunave

Një ndër pjesët e rëndësishme të procesit të Auditimit Social e përbën përzgjedhja e komunave dhe projekteve që do të monitorohen nga grupet e auditimit social. Fillimisht, procesit të përzgjedhjes u janë nënshtruar vetëm komunat që kanë përfituar nga granti i performancës. Hapi i parë ka qenë listimi i komunave dhe projekteve në mënyrë që të krijohet një bazë solide për zhvillimin e auditimit social. Hapi fillestar ka qenë i udhëhequr nga DEMOS, që në bashkëpunim me Platformën CiviKos dhe Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), kanë dërguar te të gjitha këto komuna një kërkesë për shprehje të interesimit/vullnetit për të pilotuar auditimin social. Kësaj kërkesë u janë përgjigjur pozitivisht komunat në masë të madhe, dhe rrjedhimisht ato që komuna që kanë shprehur gatishmërinë të bashkëpunojnë për zbatimin e auditimit social janë vendosur në listën e komunave potenciale për ta pilotuar auditimin social.

Pas përfundimit të fazës së parë, DEMOS së bashku me Platformën CiviKos dhe MAPL kanë bërë përzgjedhjen e projekteve duke u bazuar në kriteret si më poshtë:

Statusi i projektit (nëse është në përfundim, mbi 50% e punëve janë të përfunduara, apo është në fazën fillestare);

Targetimi dhe ndikimi i lartë apo i ulët i projekteve për grupet e marginalizuara si gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me nevoja të veçanta dhe komunitetet jo shumicë;

Natyra e projektit dhe fusha e ndikimit me prioritet në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe ambientit;

Vlera e grantit e alokuar për realizimin e projektit kapital.

Si rezultat, projektet të cilat kanë marrë më shumë pikë duke u bazuar në kriteret e lartpërmendura janë propozuar për auditim social.

Projektet e përzgjedhura janë:

- Rregullimi i Parkut Karagaq në Komunën e Pejës;
- Projekti për shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës;
- Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në Komunën e Rahovecit (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak); dhe
- Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Janjevë në Komunën e Lipjanit.

Komunat të cilat janë përzgjedhur për auditim social janë njoftuar zyrtarisht dhe të gjitha kanë shprehur gatishmërinë për të pilotuar auditimin social për projektet përkatëse të përzgjedhura.

Pas përzgjedhjes së projektit, ka filluar faza vijuese dhe më e rëndësishme e projektit – vendosja e bashkëpunimit me komunat e përzgjedhura dhe themelimi i grupeve për auditim social në terren. Kjo fazë përfshinë ishte edhe pjesa kryesore dhe e domosdoshme për një auditim social të suksesshëm.

- **Takimi përgatitor me ekzekutivin komunal:** DEMOS së bashku me Platformën CiviKos kanë zhvilluar takime me kryetarët dhe përfaqësues të komunave të Pejës, Rahovecit, Kamenicës dhe Lipjanit për t'i njoftuar së afërmi me procesin e auditimit social, si për shkëmbimin e informatat e nevojshme për projektet në fjalë. Këto takime përveç informimit të institucioneve, kanë shërbyer edhe si një mundësi për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe institucioneve lokale.

- **Përzgjedhja e kujdesshme e grupeve të auditimit social:** Një nga hapat më sfidues në këtë proces ishte përzgjedhja e grupeve të auditimit social. Platforma CiviKos e ka zhvilluar këtë hap në bashkëpunim me komunat dhe me organizatat anëtare në secilën komunë – meqë CiviKos ka një rrjet të pasur të organizatave jo-qeveritare që operojnë në nivel lokal në të gjithë Kosovën.

Grupet e auditimit social në katër komunat partnere janë përzgjedhur me kujdes të veçantë. Si kriter gjatë përzgjedhjes është marrë parasysh interesimi i qytetarëve për t'u bashkuar me grupin, si dhe ndikimi që ka projekti në jetën e tyre. Rëndësi e veçantë i është kushtuar besimit që anëtarët e komunitetit të jenë sinqerisht të bindur se grupi i auditimit social përfaqëson interesat e tyre. Një element tjetër shumë i rëndësishëm gjatë identifikimit të grupit ka qenë edhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara, apo nënperfaqësuar, duke ju dhënë zë të barabartë gjatë procesit të auditimit social. Platforma CiviKos përveç qytetarëve pjesëtarë të komunitetit, ka përfshirë po ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal. Përfshirja e organizatave është bërë me qëllim të përfitimit nga metodologjia e auditimit social e cila mund të replikohet nga ta në të ardhmen për projekte të ngjashme.

- **Trajnimi i grupeve të auditimit social:** Meqë auditimi social është koncept shumë i ri në Kosovë, DEMOS ka rekomanduar që menjëherë pas përzgjedhjes së grupeve të auditimit social të fillohet me trajnimin për auditimin social dhe informatave bazë për projektin e përzgjedhur. Në këtë fazë ekipi i DEMOS ka qenë shumë mbështetës duke ofruar asistencë edhe në trajnimin e grupeve të auditimit. Në këtë fazë janë zbërthyer të gjitha projektet e përzgjedhura dhe është krijuar kohezioni në mes të grupit.

- **Takimet e rregullta të grupeve të auditimit social:** Platforma CiviKos ka lehtësuar takimet e rregullta të grupeve të auditimit social. Gjatë takimeve të rregullta, grupet e auditimit social janë takuar në zonat ku veprojnë dhe kanë analizuar zbatimin e projektit e po ashtu kanë identifikuar gjetjet specifike.

Me qëllim të vërtetimit të gjetjeve, pranimit të informatave shtesë dhe largimit të keqkuptimeve apo keqinterpretimeve, grupet e auditimit social janë takuar edhe me përfaqësuesit e komunave përkatëse ku ishte planifikuar zbatimi i auditimit social. Grupet e auditimit social kanë zhvilluar edhe takime në terren për të parë së afërmi realizimin e investimeve që janë bërë lidhur me projektet në fjalë, dhe për të analizuar nivelin e zbatimit të projektit. E gjitha kjo është bërë me qëllim të evidentimit të gjetjeve gjatë procesit të monitorimit. Përveç vërtetimit të gjetjeve, këto takime kanë synuar ndërtimin e një fryme bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe institucioneve.

- **Përgatitja e pyetjeve dhe treguesve të auditimit social:** Grupet e auditimit social në katër komunat pilotuese kanë përpiluar pyetje specifike për komunën, kanë mbajtur takime me kryetarët e komunave, dhe drejtorët e drejtorive përkatëse për projektin që është monitoruar. Këto pyetje janë zhvilluar me inputet e qytetarëve në takimet e rregullta përmes një procesi të lehtësuar nga Platforma CiviKos dhe me mbështetjen e ekipit të DEMOS.

Pas takimit me komunat dhe marrjes së informatave, sipas nevojës janë dërguar edhe kërkesat me shkrim për sigurim të informatave apo dokumentacionit shtesë në lidhje me projektin. Pas grumbullimit të informatave dhe dokumenteve relevante janë përpiluar gjetjet kryesore dhe rekomandimet për komunën.

- **Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me katër komunat partnere:** Me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit me komunat pilotuese, Platforma CiviKos ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me katër komunat partnere. Memorandumi i bashkëpunimit formalizon bashkëpunimin në mes të Platformës CiviKos dhe komunave partnere. Me anë të memorandumeve të nënshkruara komunat janë dakorduar që të përpilojnë një plan të veprimit 3-6 muaj pas procesit të monitorimit, atëherë kur grupi i qytetarëve të ketë të përpiluar raportin e monitorimit dhe prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Kjo me qëllim për të siguruar përcjelljen dhe progresin e arritur në drejtim të adresimit të gjetjeve dhe rekomandimeve.

PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Themelimi i Grupit të Auditimit Social në Rahovec

Më qëllim të identifikimit dhe përzgjedhjes së pjesëtarëve Grupit të Auditimit Social në Rahovec, dhe duke marrë parasysh veçantinë e projektit, fillimisht janë kontaktuar përfaqësuesit e shoqatës HANDIKOS në Rahovec që punojnë për promovimin e të drejtave të personave me nevoja të veçanta. Më specifikisht, për personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Pasi projekti i zbatuar nga Komuna e Rahovecit, “Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me Nevoja të Veçanta (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogel, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak”, kryesisht ka qenë ndërtim i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta, fillimisht janë identifikuar pjesëtarët dhe anëtarët e HANDIKOS në Rahovec. Pas takimeve fillestare me HANDIKOS, janë identifikuar edhe disa nga anëtarët e grupit. Më vonë grupit i janë bashkangjitur edhe psikologë, sociologë dhe prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në total, në Rahovec janë identifikuar dhe përzgjedhur 21 pjesëtarë të Grupit të Auditimit Social, prej të cilëve dhjetë janë burra dhe njëmbëdhjetë janë gra. Edhe në këtë grup është arritur përfshirje e kënaqshme gjinore, si dhe përbërja e grupit është kryesisht nga persona me nevoja të veçanta apo familjarë të tyre.

Sa i përket profesioneve, anëtarët e Grupit të Auditimit Social në Rahovec janë si më poshtë:



Menjëherë pas konsolidimit të Grupit të Auditimit Social në Rahovec, Platforma CiviKos ka organizuar trajnimin dyditor për Grupin e Auditimit Social në Rahovec me 5 dhe 6 nëntor 2022. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë mësuar rreth funksionimit të nivelit lokal, procesit të monitorimit të kontratave si qytetarë aktiv dhe janë njoftuar me hapat e procesit të auditimit social.

Takimet e Rregullta të Grupit të Auditimit Social në Rahovec

Menjëherë pas trajnimit dhe konsolidimit të Grupit, pjesëtarët kanë filluar takimet e rregullta. Grupi i Auditimit Social në Rahovec gjithsej ka mbajtur pesë takime, në mesin e të cilave edhe 2 takime me përfaqësues të Komunës së Rahovecit.

Qëllimi Specifik i Grupit të Auditimit Social në Rahovec

Qëllimi specifik i Grupit të Auditimit Social në Rahovec ka qenë matja e ndikimit të zbatimit të projektit 'Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me Nevoja të Veçanta (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak' që ka tek personat me nevoja të veçanta. Përmes monitorimit të kësaj kontrate, grupi ka shikuar nëse ky është ndërtuar sipas standardeve dhe nevojave të gjitha kategorive të personave me nevoja të veçanta. Përmes këtij aktiviteti gjetjet dhe rekomandimet synojnë t'i adresojnë të gjitha mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit të kontratës dhe t'i ofrojnë Komunës të Rahovecit hapësirë për bashkëpunim përgjatë projekteve të ngjashme në të ardhmen.

Indikatorët e performancës të përgatitur nga grupi i Auditimit Social për projektin e monitoruar janë si vijon:

- Konsultimi publik me grupe të qytetarëve specifikisht me persona me nevoja të veçanta.
- Realizimi i punimeve në kohë sipas kontratës.
- Kënaqshmeria e grupit të auditimit social rreth cilësisë së punëve të përfunduara.
- Vendosja e shenjave, zhurmueseve, pjerrinave dhe intervenimeve të tjera, sipas kontratës .
- Mirëmbajtja e investimit pas përfundimit të kontratës.

Kërkesat për informacion/dokumente si dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Rahovec tek Komuna e Rahovecit

Duke marrë parasysh natyrën e projektit, grupi i auditimit social për të mbledhur informacion të nevojshëm për procesin, ka kërkuar nga Komuna e Rahovecit dokumentet dhe informacionet si më poshtë:

- Ftesat dhe procesverbalet që Komuna i posedon për pjesëmarrje të qytetareve gjatë dëgjimeve buxhetore/konsultimeve publike për projektin: "Ndërtimi i Infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta" (Rahovec, Xerxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogel, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn, Qifllak) - Të sigurohen procesverbalet e dëgjimeve/konsultimeve publike për projektin në fjalë.
- A është përfunduar projekti në tërësi?
- Nëse po a mund ta kemi një raport të përfundimit dhe shpenzimeve të realizuara?

- Nëse jo kur pritet të përfundohet projekti?
- A ka pasur nevojë për buxhet shtesë për zbatim të projektit?
- A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit dhe nëse ka pasur, cilat ishin e arsytet e vonesave?
- Caktimit të lokacioneve a i ka paraprirë një analizë se ku duhet vendosur pjerrinat, ku zhurmuesit, parkingjet e rezervuara, etj.?
- Nëse po, të sigurohet analiza/studimi i tillë.
- A është monitoruar në baza të rregullta implementimi i projektit nga ana e Komunës? A kemi ndonjë raport të monitorimit dhe nëse po të sigurohet për Grupin ?
- A është paraparë ndërtimi i pjerrinave edhe në Sheshin e Rahovecit?
- A janë vendosur pjerrinat në të gjitha institucionet shkollore dhe të tjera publike? Sa?
- Nga vizitat në terren është vërejtur se pjerrinat nuk janë të punuara sipas standardeve të pjerrtësisë? A keni informata pse nuk janë punuar sipas standardeve?
- Në Sheshin e Rahovecit gjatë vizitave është vërejtur se nuk funksionojnë zhurmuesit për persona me nevoja të veçanta. A keni informata pse nuk funksionojnë?
- A është bërë furnizimi dhe vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale të cilat njoftojnë personat me nevoja të veçanta për shtegun në të cilin mund të kalojnë me karroca?
- A është bërë furnizimi dhe vendosja e rrethojave metalike dhe a është paraparë mirëmbajtja e tyre pasi që një pjesë konstatohet nga qytetarët se janë të demoluara?
- A është bërë furnizimi dhe vendosja e 4 tabelave informuese – tabelë ku tregohet harta me rrugët e qytetit e pajisur edhe me informatat për këto mundësi për kalimin e personave me nevoja të veçanta? Sa janë informacionet në këto tabela gjithëpërfshirëse në informimin që e bëjnë për personat me nevoja të veçanta?
- Lidhur me parkingjet e rezervuara (50) për persona me nevoja të veçanta në parkingjet e institucioneve shkollore dhe institucioneve të tjera publike:
- A është bërë furnizimi me ngjyrë të verdhë?
- A janë vendosur shenjat vertikale?
- Krijimi i ishujve të cilët lejojnë manovrimin për ngasësit me nevoja të veçanta?
- A keni menduar ta përmirësoni infrastrukturën në objektin e Komunës për qasje për persona me nevoja të veçanta – sidomos për takimin e qytetarëve me nevoja të veçanta me Kryetarin e Komunës (pasi në raste të tilla në mungesë të një ashensori e kanë të pamundur të qasen tek zyra e Kryetarit dhe zakonisht takimet duhen mbajtur në sallën e asamblesë)?
- A është menduar që në intervenime e investime të ngjashme të investohet edhe në transport publik/urban e rural për të përmirësuar infrastrukturën që mundëson qasjen më të lehtë për personat me nevoja të veçanta?
- A është e paraparë me kontratë mirëmbajtja e këtij investimi?

RRETH PROJEKTIT

Projekti	Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me nevoja të veçanta (Rahovec, Xerxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak)
Çmimi total i punëve në kontratë	EUR 71,569.00
Statusi i kontratës	I përfunduar



Figura 1. Harta me investimet të infrastrukturës për qasje e personave me nevoja të veçanta në qytetin e Rahovecit.

GJETJET KRYESORE

Disa nga gjetjet kryesore për zbatimin e projektit 'Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me nevoja të veçanta (Rahovec, Xerxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogel, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak)' janë të përmbledhura në vijim:



- Mungesa e organizimit të konsultimit publik me qytetarë: Për projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës për Persona me nevoja të veçanta (Rahovec, Xerxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogel, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak)", Komuna e Rahovecit nuk ka organizuar konsultim të veçantë, sidomos gjatë pjesës së dizajnit dhe planifikimit. Një konsultim i tillë është edhe më i nevojshëm për faktin se ky projekt nuk përfshinë vetëm pjesën e qytetit të Rahovecit mirëpo edhe 11 fshatra të tjera. Gjithsesi, duhet theksuar se ky projekt është rezultat i takimeve dhe konsultimeve e shpeshta me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Rahovecit. Duke qenë se ky Këshill në përbërje ka përfaqësuesve komunal, të policisë dhe sigurisë, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë dhe përfaqësues të komunitetit të personave me nevoja të veçanta, mund të konstatohet se kërkesa për një projekt të tillë ka dalë nga vet përfaqësuesit e këtij komuniteti. Në procesverbalin e siguruar nga Komuna e Rahovecit të mbledhjes së këtij Këshilli të mbajtur në shtator të vitit 2020, në rend dite ka qenë edhe identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta. Kërkesë specifike ishte bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe policinë për identifikimin e të gjitha hapësirave dhe objekteve që nuk kanë qasje për personat me nevoja të veçanta. Anëtarët e Këshillit ishin pajtuar unanimisht për përpilimin e një plan i përbashkët për mundësimin e qasjes më të lehtë dhe të mirë.



- Mungesa e pjerrinave dhe infrastrukturës mbështetëse për personat me nevoja të veçanta në vendet me frekuentim të lartë: Grupi i Auditimit Social ka identifikuar se pjerrinat janë vendosur në vendkalime për këmbësorë si dhe në shkollat ku kanë munguar, por jo edhe në hapësirat publike me frekuentim të shpeshtë. Një ndër vendet me frekuentim të lartë të qytetarëve është edhe vet objekti i Komunës së Rahovecit, më saktësisht pjesa ku gjendet edhe zyra e Kryetarit. Duke qenë se qëllim primar i këtij projekti ka qenë sigurimi i qasjes më të mirë të personave me nevoja të veçanta në institucione publike, kjo qasje apo infrastrukturë mbështetëse nuk është siguruar në Komunën e Rahovecit që t'iu mundësojë qasje më të lehtë tek zyra e Kryetarit për të diskutuar rreth shqetësimeve që mund të kenë. Kjo për arsye se zyra e Kryetarit gjendet në katet më të larta të objektit dhe nuk ekziston ashensori që do të mundësonte qasjen e këtyre personave në atë zyrë.



- Vonesa në realizimin e projektit: Kontrata për projektin në fjalë ishte nënshkruar me 12 gusht 2021, megjithatë punët në këtë projekt kishin filluar me 7 tetor 2021. Sipas dokumenteve të kontratës, kohëzgjatja e punëve

do të duhej të ishte 120 ditë. Grupi i Auditimit Social ka identifikuar se ka pasur vonesa në zbatim të projektit. Sipas kontratës, punët do të duhej të përfundonin me 4 shkurt 2022. Sidoqoftë, projekti ka përfunduar me 19 gusht 2022. Kjo vonesë prej 196 ditësh kishte rrjedh si pasojë e mangësive në matjet/dizajnin teknik të projektit. Rrethojat fillimisht ishin planifikuar me dimensione më të mëdha se trotuaret, dhe pastaj është dashur të bëhen matje të serishme dhe intervenim shtesë për t'i zvogëluar dhe përshtatur me trotuaret.



- **Pjerrinat jashtë standardit:** Grupi i Auditimit Social ka evidentuar se disa nga pjerrinat e vendosura në qytetin e Rahovecit janë më të ngushta se standardi i lejuar për të kaluar një person me karrocë. Të njëjtave ju mungojnë edhe anësoret për mbajtje, duke bërë kështu që investimi të mos arrij vlerën për paranë dhe të përmbush qëllimin e tij në krijimin e infrastrukturës së nevojshme dhe të sigurte për personat me nevoja të veçanta. Sipas Komunës kjo vjen si pasojë e trotuareve të ngushta, hapësirave pamjaftueshme për vendosjen e mbajtësve dhe refuzimit nga ana e bizneseve për t'i vendosur para hapësirave të lokaleve. Megjithatë Grupi i Auditimit Social konsideron se Komuna është dashur të identifikoj këto rreziqe dhe sfida para fillimit të projektit në mënyrë që të evitohen vonesat dhe investimet të cilat nuk përmbushin nevojat e qytetarëve.



- **Zhurmesit e vendosur në semaforë kanë pak zhurmë:** Grupi i Auditimit Social ka identifikuar se në disa prej semaforëve të vendosur zhurmuesit nuk punojnë fare, e disa kanë zë shumë të dobët për t'u dëgjuar mirë nga personat e verbër apo personat me vështirësi në dëgjim. Në veçanti mungon infrastruktura në vendkalimin e këmbësorëve që orienton personat e verbër për vendin nëpër të cilin mund të kalojnë.



- **Mungesa e shënjitimit të plotë të infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta:** Monitorimi i projektit në fjalë ka identifikuar se nuk janë vendosur të gjitha shenjat vertikale dhe horizontale në qytetin e Rahovecit që njoftojnë për shtigjet për persona me nevoja të veçanta.



- **Mungesa e mekanizmave për sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit:** Një ndër gjetjet e Grupit të Auditimit Social është po ashtu fakti që Komuna e Rahovecit nuk ka kontratë të veçantë për mirëmbajtje të rrethojave, pjerrinave dhe shenjave. Në mungesë të një mirëmbajtje të mirëfilltë dhe të rregullt, mund të konstatohet se kjo infrastrukturë e krijuar deri më tani lehtë mund të dëmtohet dhe të mos i shërbejë qëllimit për të cilin është synuar fillimisht.



- **Dëmtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta nga projekte tjera të realizuara nga komuna:** Në sheshin e Rahovecit pjerrinat janë dëmtuar gjatë ndërtimit të sheshit dhe aktualisht nuk ka pjerrina për persona me nevoja të veçanta në shesh. Duke qenë që të dy projektet janë projekte të Komunës, Grupi i Auditimit Social konsideron se Komuna nuk ka bashkëpunim dhe bashkërendim të prioriteteve dhe planifikimit të resurseve brenda institucionit me qëllim të racionalizimit të investimeve publike. Komuna gjatë takimit të fundit me Grupin e Auditimit Social ka premtuar se pjerrinat në shesh do të vendosën.

REKOMANDIMET

- Grupi i Auditimit Social i rekomandon Komunës së Rahovecit të angazhohet në ndërtimin e pjerrinave në hapësirat publike me frekuentim të shpeshtë, duke filluar edhe nga vet objekti i komunës, e që do t'i mundësonte personave me nevoja të veçanta qasje më të lehtë tek zyra e Kryetarit për të diskutuar rreth shqetësimeve që mund të kenë.
- Po ashtu, Grupi i Auditimit Social rekomandon që brenda objektit të komunës të instalohet një ashensor që mundëson qasjen e personave me nevoja të veçanta tek zyra e Kryetarit, e cila ndodhet në katet më të larta të objektit.
- Komuna duhet të harmonizoj planet investive dhe të rris bashkëpunimin ndërmjet mbikëqyrësve dhe implementuesëve të projekteve komunale që mund të kenë interes të tërthorët. Një bashkëpunim i tillë do të ndikonte në harmonizimin e investimeve dhe do të evitonte sfidat sikurse në rastin e ndërtimit të sheshit, ku pjerrinat janë dëmtuar. Ky rast përveç që ka shkaktuar sfida në qarkullimin e personave me nevoja të veçanta në atë pjesë, gjithashtu mund të rris koston e riparimit, qoftë ajo në anën e operatorit ekonomik.
- Komuna duhet të siguroj që pas ndërtimit të sheshit në Rahovec të vendosen pjerrina për persona me nevoja të veçanta.
- Komuna të angazhohet në gjetjen e një zgjidhjeje për zgjerimin e pjerrinave të vendosura në vendkalime për këmbësorë aty ku janë vendosur me gjerësi nën standardin ku mundësohet kalimi i një personi me karrocë. Në rast se kjo nuk bëhet, investimi do të mbetet i pashfrytëzueshëm dhe nuk do të arrij qëllimin e tij.
- Të rritet zhurma e semaforëve që sinjalizon personat e verbër dhe personat me vështirësi në dëgjim që janë përdorues të semaforëve në qytetin e Rahovecit.
- Të vendosën të gjitha shenjat vertikale dhe horizontale që tregojnë vendkalimet për persona me nevoja të veçanta për të gjithë përdoruesit. Po ashtu, për të evituar vonesat në projektet e ardhshme, Komuna duhet të identifikoj më mirë rreziqet që mund të ketë një projekt dhe të bëjë një planifikim më të mirë për menaxhimin e tyre. Sikurse problemet me pronarët e bizneseve të ishin identifikuar në fazën e planifikimit, do të mund të adresoheshin para fillimit të punëve. Rrjedhimisht, do të ishin evituar vonesat në realizimin e projekteve apo rezistenca në vendosjen e shënjimeve të nevojshme.
- Komuna e Rahovecit të përfshijë mirëmbajtjen e rrethojave, pjerrinave, shenjave vertikale dhe horizontale në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve.

LISTA E PËRBËRJES SË GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	Mejreme Gerguri Krasniqi	Ekonomiste
2	Shaip Shala	Jurist
3	Leontina Cena	Arkitekt
4	Alba Jupa	Arkitekt
5	Erza Metkamberi	Arkitekt
6	Venhare Shtavica	Aktiviste
7	Blerim Cena	Akivist
8	Bejram Kryeziu	Anëtar i HANDIKOS
9	Selman Shtavica	Anëtar i HANDIKOS
10	Burim Elshani	Anëtar i HANDIKOS
11	Agron Neziri	Akivist
12	Gazdrit Durguti	Anëtar i HANDIKOS
13	Qazim Daka	Anëtar i HANDIKOS
14	Leonora Rama	Akivist
15	Remzije Haxhimurati	Anëtare e HANDIKOS
16	Qendrim Ramadani	Anëtar i HANDIKOS
17	Teuta Shehu	Anëtare i HANDIKOS
18	Zana Qmega	Logoped
19	Anduena Shtavica	Psikolog
20	Edmond Kabashi	Psikolog
21	Haxhi Hoxha	Drejtor i HANDIKOS
22	Gjzide Raba	Qytetare Aktive / Prind i fëmijës me nevoja të veçanta

